

## Konferenca TeachBeyond Shqipëri

Me gëzim presim të jemi së bashku në Konferencën e 6-të vjetore të mësuesëve me temë:

### *Edukimi që ndërton mençurinë*

## Biografia e Prezantueses - Lori Neuman



**Lori Neuman** është Drejtoresha e Shkollës Ndërkombëtare të Krishterë GDQ në Vaqarr, Shqipëri. Me origjinë nga SHBA-ja, Lori jeton në Shqipëri prej 20 vjetësh dhe shërben në një sërë rolesh mësimdhënëse dhe administrative që përfshijnë mësimdhënien në klasë, zbatimin e kurrikulës dhe drejtimin e shkollës. Ajo ka një diplomë Bachelor në Gazetari nga Universiteti i Kansasit dhe një master në Lidership Arsimit nga Universiteti i Teksasit të Veriut.

Lori bashkon urtësinë e udhëheqjes me mençurinë praktike të klasës, duke ndihmuar edukatorët, stafin dhe vullnetarët të lidhen me nxënësit, të bashkëpunojnë në mënyrë efektive me prindërit, dhe të rrisin ekipe të shëndetshme. Ajo njihet për stilin e saj të ngrohtë, relational dhe për ndjeshmërinë ndërkulturore. Qoftë duke trajnuar stafin, duke ndihmuar në zhvillimin profesional të mësuesve, apo duke folur me grupe më të gjera të komunitetit, qëllimi i Lorit mbetet i njëjtë: komunikim i qartë, bashkëpunim i fortë dhe një kulturë shkollëre ku nxënësit lulëzojnë.

## Workshop 1

### *Ndërtimi i një kulture pozitive në klasë.*

#### **Fokusi:**

Rutinat praktike, gjuha dhe struktura që ndihmojnë çdo nxënës të ndihet i dukshëm, i sigurt dhe i gatshëm për të mësuar.

## **Përshkrimi:**

Një kulturë e shëndetshme në klasë nuk ndodh rastësisht, ajo ndërtohet me punë dhe praktika të qarta, gjuhë të qëndrueshme dhe momente të vogla të përditshme që komunikojnë dinjitet dhe përkatësi. Në këtë seminar, pjesëmarrësit do të mësojnë praktika të thjeshta dhe të përsëritshme për të krijuar një mjedis ku nxënësit angazhohen, marrin rreziqe dhe mbështesin njëri-tjetrin.